



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIJA ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësi org. Org. Jedinica Org. Unit	ARPL
№ i Prot. Broj Prot. Prot. No.	7410-2/23
№ i Faqeve Br. Stranica No. Pages	-03-
Date:	13. 03. 24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalvog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	07.12.2023
REFERENC-Ë:	7410/23 - ARPL
PËR/ZA/TO:	„CUFA-COM“ SH.P.K., Klllokot - K.Klllokot
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së Naser HAFIZI- Zëvendësues i Udhëheqësit të ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Myrvete Mulaj - Zyrtare përgjegjëse për akte ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore, Shfrytëzim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore pranë Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën me Nr. të protokollit: 7410/23, për shfrytëzim të ujit nga pusi, Bazë Betoni me prodhime e betonit ne Klllokot - K.Klllokot dhe ka vendosur si në Vendimin për Leje Ujore, pas plotësimit të dokumentacionit për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. L.U.

Datë: 11.03.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjensive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „CUFA-COM“ SH.P.K., Klllokot - K.Klllokot, me Nr. prot. 7410/23, për **LEJE UJORE**, për shfrytëzimin e ujërave nëntokësor nga Pusi për Bazë Betoni me prodhime të betonit, sipas kushteve vijuese:

1. Uji për shfrytëzim nga Pusi 1 do të jetë, $Q_{max}=2.81$ l/s (dy pikë tetëdhjete e nje), sipas kërkesës së projektit të dorëzuar, në pikën me koordinata $X= 7 530 628$ dhe $Y = 4 690 153$;
2. Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësit, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m^3 /ditë), dhe sasinë vjetore (m^3 /vit). Për sasinë e shfrytëzuara pala obligohet që për çdo gjashtë muaj të informoj me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së lejes ujore.



3. Nr. Serik i ujëmatësit për pusin, duhet prezantuar në ARPL/MMPHI, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij vendimi, si dhe për ndërrimin e mundshëm të tij, duhet informuar Organi përgjegjës, që e ka lëshuar këtë vendim;
4. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas UA në fuqi për Strukturën e pagesave të ujit;
5. Për këtë pala obligohet të raportoj për perioda kohore të shfrytëzimit, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
6. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (Pesë) vite, me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës;
7. Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të paraqes kërkesë për vazhdimin të lejes ujore;
8. Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvogëlimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të lejes ujore;
9. Leja ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën;
10. Pala duhet të beje sigurimin e pusit;
11. Validiteti i Lejes Ujore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të kërkuara më sipër;

Arsyetim

Zyrtarja përgjegjëse, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim për Leje ujore - shfrytëzim i ujit nga puset për Bazë Betoni për prodhimin e betonit, bashkangjitur Dokumentacioni i kompanisë, Çertifikata e Regjistrimit të Bisnesit -ARBK - "CUFA-COM" Sh.p.k, Leja nga komuna e Kllokotit me nr. 366815, dt.14.08.2013, leje nga KPMM 4313, dt.26.11.2018, , Leje Mjedisore nga MMPH nr. 2234/19 dt. 03.02.2021, „CUFA-COM” Sh.p.k., Çertifikatë e pronësisë, Kopja e Planit , Koordinatat, Elaborati i punuar nga Kompania “ F & K ” Shpk,



plani i situacionit i nenshkruar dhe i vulosur nga Valton Sylja, Gjeodet i Licencuar,
në përpjesë të lexueshme,

Situacioni i terrenit 1:1000, CD.

Faturat e pagesave për Kushte Ujore , Pëlqim Ujor dhe Leje Ujore.

Andaj, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, akteve administrative të lëshuara nga organet kompetente, legjislacionit për ujërat për shqyrtimin e aplikacioneve për akte ujore, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 7410/23 - ZSP- 2023 Datë: 22.12.2023

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Kllokot;
- Arkivit të Ministrisë.

Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së



Izedin BYTYQI